



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI**

Komisioni I Ekonomise, Financave dhe Privatizimit

R E L A C I O N

**PER DEKRETIN E PRESIDENTIT TE REPUBLIKES "PER
KTHIMIN E LIGJIT NR.8450, DATE 29.1.1999 "PER
PERPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTAES,
GAZIT DHE TE NENPRODUKTEVE TE TYRE"**

Ne mbledhjen e dates 17 janar 1999 Komisioni I Ekonomise, Financave dhe Privatizimit shqyrtoi dekretin e Presidentit te Republikes "Per kthimin e ligjit nr.8450, date 28.1.1999 "Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, gazit dhe te nenprodukteve te tyre".

Ne mbledhjen e Komisionit ishin thirrur per te dhene spjegime per kete ligj zoti Ylli Bufi, minister I Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe specialiste te Drejtorise se Standarteve dhe Cilesise.

Pas diskutimeve te shumta, Komisioni vendosi t'I propozoje Kuvendit qe ketij ligji t'I behen ndryshimet qe vijojne:

- Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Inspektoriati Shteteror I Hidrokarbureve

1. Organi shteteror, I specializuar per kontrollin e veprimtarise se personave juridike te ushtruar ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, eshte Inspektoriati Shteteror I Hidrokarbureve, qe funksionon dhe varet nga ministri pergjegjes per hidrokarburet.

Ne perberje te ketij Inspektoriati funksionon laborator qendror I hidrokarbureve.

2. Inspektoriati Shteteror I Hidrokarbureve pergjigjet per ushtrimin e kontrollit per zbatimin e kushteve te parashikuara ne lejet apo autorizimet perkatese qe u jane dhene personave juridike, ne instalimet, impiantet dhe

S.A.
29/2/99
[Signature]


pajisjet e perdorura, ne menyre qe ato te respektojne normat teknike te masave mbrojtese ndaj zjarrit, treguesit cilesore, standartet shteterore dhe dispozitat ligjore e nenligjore, me qellim parandalimin e abuzimeve dhe falcifikimeve qe mund te kryhen nga personat juridike. Per realizimin e ketyre detyrave ai bashkepunon me organet e tjera shteterore.

Rregullat per organizimin, funksionimin dhe veprimtarine e Inspektoriatit Shteteror te Hidrokarbureve percaktohen nga Keshilli I Ministrave."

- Ne tekstin e ligjit, kudo ku hasen fjalet "Inspektoriat Shteteror I Karburanteve" te zevendesohen me fjalet "Inspektoriat Shteteror I Hidrokarbureve".

SEKRETARI I KOMISIONIT

Gaqo Apostoli



S.P.
29/2/89

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit

RELACION
PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS "PËR
KTHIMIN E LIGJIT NR.8450, DATË 28.1.1999 "PËR
PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS,
GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE"

Në mbledhjen e datës 17 janar 1999 Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit shqyrtoi Dekretin e Presidentit të Republikës "Për kthimin e ligjit nr.8450, datë 28.1.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre".

Në mbledhjen e Komisionit ishin thirrur për të dhënë shpjegime për këtë ligj zoti Ylli Bufi, ministër i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe specialistë të Drejtorisë së Standarteve dhe Cilësisë".

Pas diskutimeve të shumta, Komisioni vendosi t'i propozojë Kuvendit që këtij ligji t'i bëhen nryshimet që vijojnë:

- Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre.

1. Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji është Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

Në përbërje të këtij Inspektoriati funksionon Laboratori Qendror i Kontrollit.


2. Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre përgjigjet për ushtrimin e kontrollit për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse që u janë dhënë personave juridikë, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të respektojnë normat teknike të masave mbrojtëse ndaj zjarrit, treguesit cilësorë, standartet shtetërore dhe dispozitat ligjore e nënligjore, me qëllim parandalimin e abuzimeve dhe falsifikimeve që mund të kryhen nga personat juridikë. Për realizimin e këtyre detyrave ai bashkëpunon me organet e tjera shtetërore.

Rregullat për organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Inspektoriatit Shtetëror të Kontrollit të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

- Në tekstin e gjithë ligjit kudo ku haset emërtimi "Inspektoriat Shtetëror i Karburanteve" zëvendësohet me emërtimin : "Inspektoriati Shtetëror i Kontrollit të naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre".

SEKRETARI I KOMISIONIT TË EKONOMISË
Gaço Apostoli

Tiranë, më 24.2.1999



5.P.
24/2/99